

INVESTIGIME

ANALIZA

LAJME ▾

REPORTAZHE ▾

OPINION ▾



TEMA: VITI 2025

ZGJEDHJE 2025 ▾

VETING ▾

MJEDESI

SPAK

EDI RAMA

BELINDA BALLUKU

INTERVISTA

SALI BERISHA

ERION VELIAJ

DONALD TRUMP

Fillimi > Mos humbisni > Korrupsioni

Dorëheqja e Joana Qeleshit, pas barrës së provës për pasurinë dhe figurën

Nga [Aleksandra Bogdani](#) — 18:52 | 08/11/2019 Në Korrupsioni, KPK, Lajme, Në Fokus

Kohe leximi: 2 minuta

AA 0



Gjyqtarja e larguar me dorëheqje, Joana Qelesi së bashku me ish-kreun e Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori dhe ish-kreun e Apelit, Hysni Demiraj gjatë zgjedhjes së anëtarëve të KLGJ. Foto: LSA

 Share on Facebook

 Share on Twitter

 G+



Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit tregon se kryetarja e Gjykatës së Durrësit, Joana Qelesi dha dorëheqjen 10 ditë pasi i kaloi barra e provës për pasurinë dhe pastërtinë e figurës – duke ndërprerë procesin e vetingut.



Gjyqtarja e larguar me dorëheqje, Joana Qeleshi së bashku me ish-kreun e Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori dhe ish-kreun e Apelit, Hysni Demiraj gjatë zgjedhjes së anëtarëve të KLGJ. Foto: LSA

Kryetarja e Gjykatës së Durrësit, Joana Qeleshi u largua me dorëheqje nga sistemi gjyqësor më 24 tetor, me motivin e “angazhimit në një pozicion tjetër pune”. Megjithatë, një vendim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit zbulon se Qeleshi e dorëzoi dorëheqjen dhjetë ditë pas mbylljes së hetimit administrativ, që e ngarkonte atë me barrën e provës për kriterin e pasurisë dhe atë të pastërtisë së figurës.

Procesi i vetingut për gjyqtaren Joana Qeleshi nisi në 15 mars 2018 nga një trupë gjyqësore e drejtuar nga Genta Tafa Bungo, me relatore Etleda Çiftja dhe anëtare Pamela Qirko. Sipas vendimit të KPK-së, më 14 tetor 2019, trupi gjykues në prani të vëzhguesit ndërkombëtar arriti në përfundimin

se provat “në lidhje me kriterin e pasurisë dhe kontrollit të figurës kanë nivelin e provueshmërisë” dhe vendosi mbylljen kryesisht të hetimit.

E njoftuar përmes postës elektronike për mbylljen e hetimit dhe kalimin e barrës së provës, Qeleshit i është bërë me dije që mund të paraqiste shpjegime apo prova në lidhje me rezultatet e hetimit jo më vonë se data 29 tetor.

Por në vend të shpjegimeve të gjyqtarës, në KPK mbërriti më 24 tetor një vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor ku miratohej kërkesa për dorëheqje dhe njëkohësisht mbarimi i statusit të gjyqtarit për Joana Qeleshin.

Në vendimin e KPK-së ku deklarohet ndërprerja e procesit të vetingut për Qeleshin thuhet se 4 ditë pas dorëheqjes, ish-kryetarja e Gjykatës së Durrësit ka paraqitur përmes postës elektronike sqarimet dhe kundërshtimet e saj në lidhje me gjetjet e parashtruara nga hetimi administrativ. Qeleshi i kërkoi gjithashtu KPK-së ndërprerjen e procesit të vetingut.

Më 6 nëntor, KPK vendosi që procesi i rivlerësimit për Qeleshin duhet të ndërpritet bazuar në nenin G të Kushtetutës, i cili u njeh subjekteve të drejtën për t'u larguar nga sistemi me dorëheqje. Për pasojë, Qeleshi humbet të drejtën për të punuar në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare.

Më të lexuarat

Etiketa: [Etirida Çirrija](#) [Genta Tafa Bungo](#) [Gjykata e Rrethit Durrës](#) [Gjykatë](#) [Gjykatës](#) [Gjyq](#)

[Gjyqtare](#) [Hysni Demiraj](#) [Këshillit të Lartë Gjyqësor](#) [KLGJ](#) [Komisioni i Pavarur i Kualifikimit](#) [KPK](#)

F [Procesi i Vetingut](#) [Vendim](#) [Vendim](#) [Vezhguesit](#) [Xhezair Zaganjori](#)



Saga e hetimit pasuror: Si i shpëtoi konfiskimit biznesi i ndërtimit i Ben Qimes

🕒 07:43 | 15/12/2025



Dorëheqja e Joana Qeleshit, pas barrës së provës për pasurinë dhe figurën

🕒 18:52 | 08/11/2019



Manipulime, zhvatje dhe pengmarrje: Grupi kriminal pas 'Shqipërisë digjitale'

🕒 08:06 | 23/12/2025



Dosja e SPAK: Fitimet marramendëse të kontraktorëve të AKSHI

🕒 08:13 | 24/12/2025



Kanabis dhe kokainë: Dosja e SPAK kundër grupit të djalit të ish-deputetit të PS

🕒 07:10 | 22/12/2025



Kapja e AKSHI nga interesa kriminale rrezikon sigurinë kombëtare

🕒 08:00 | 19/12/2025

Reporter.al

Opinion

Reportazhe

Analiza

Investigime

Rreth nesh

Stafi

Kontakti

Ankesa dhe
Korrigjime

Follow Us



Lajme

Blog

Rajoni

**Politika e
privatësisë dhe
rregulla të tjera**

**Letra për
redaktorin**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

© 2014 - 2021 Reporter.al - BIRN

Dev by Aplikacione.com